REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 32/17
Datë/Datum. 06.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 32/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Stewart Inspect Kosova sh.p.k"-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shqyrtimi i Ashensorëve në Ndërtesat Qeveritare dhe Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë- Ritender " me nr. prok. AP 202/16/005/236, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /Ministria e Administratës Publike/, në seancën e datës: 23.02.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Stewart Inspect Kosova sh.p.k"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shqyrtimi i Ashensorëve në Ndërtesat Qeveritare dhe Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë- Ritender" me nr. prok. AP 202/16/005/236, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /Ministria e Administratës Publike/ (MAP).

II. **Anulohet,** njoftimi për për dhënie të kontratës i autoritetit kontraktues, /Ministria e Administratës Publike/, përkitazi me aktivitetin të prokurimit "Shqyrtimi i Ashensorëve në Ndërtesat Qeveritare dhe Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë- Ritender " me nr. prok. AP 202/16/005/236, si i pa bazuar, dhe lënda kthehet në ritenderim, nëse edhe më tutje ka interes autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr.04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj;

V. Me qenë se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "Stewart Inspect Kosova sh.p.k" - Prishtinë, janë pjesërisht të qëndrueshme, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:05.12.2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt:12.12.2016, ku kanë marr pjesë katër operator ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:10.01.2017 ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Ealga" Prishtinë

Kundër njoftimit për dhënie te kontratës të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik "Stewart Inspect Kosova sh.p.k"-Prishtinë me dt:13.01.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:20.01.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Stewart Inspect Kosova sh.p.k"-Prishtinë

Operatori ekonomik ankues "Stewart Inspect Kosova sh.p.k"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 30 janar 2017 me nr. 32/17 kundër njoftimit për dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, "Furnizim me pajisje për detektimin e heliumit" "Shqyrtimi i Ashensorëve në Ndërtesat Qeveritare dhe Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë- Ritender" me nr. prokë. AP 202/16/005/236, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues

AK Ministria e Administratës Publike duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi
- Neni 59 Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60 Kriteret për Dhënie te Kontratës
- Neni 72 Dokumentacion dhe Informata Shtesë

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 13.02.2017 i ka rekomanduar panelit shqyrtues që ta aprovoj si pjesërisht të bazuar ankesën e OE ankues "Stewart Inspect Kosova sh.p.k"-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shqyrtimi i Ashensorëve në Ndërtesat Qeveritare dhe Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë - Ritender " me nr. prok. AP 202/16/005/236, dhe njëherit ta anuloj këtë aktivitet të prokurimit tw iniciuar nga AK- "Ministria e Administratës Publike", në bazë të nenit 62 të LPP-së, pasi që kriteret e kërkuara ne dosje nuk janë identike në njoftimin për kontratë siç parashihet ne nen 27.4 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues, me datë 16. 02.2016, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në,se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues përmes përgjigjes me shkrim të dt:16.02.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23. 02. 2017, e cila është mbajtur pa praninë e palëve konform nenit 28. 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali

mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues deklaroj: i sqaroj panelit shqyrtues se sa i përket pretendimit të parë ankimor lidhur me kërkesën për autorizimin origjinal apo kopje të noterizuar, OE ankues ka ofruar autorizim kopje të pa noterizuar. Po ashtu AK nuk e ka pa të nevojshme zbatimin e nenit 72 të LPP-së, pasi kërkesa ka qenë e qartë dhe ajo nuk është përmbushur sipas kërkesës së AK nga ana e OE ankues.

Po ashtu AK nuk ka vepruar në harmoni me nen 59.4 të LPP-së gjatë vlerësimit të ofertave pasi në dosje për kuotim të çmimit nuk është kërkuar certifikata e TVSH-së. Po ashtu me rastin e përpilimit të dosjes kemi të bëjmë me shkelje të nenit 27 par. 4, pasi kërkesa në dosje dhe kërkesa për njoftim për kontratë nuk janë identike.

Në dosje të tenderit nuk është kërkuar certifikata e TVSH-së, ndërsa në njoftimin për kontratë është kërkuar certifikata e TVSH-së. Duke u bazuar në atë qe ceka më lart, i rekomandoj panelit shqyrtues qe te aprovoj si pjesërisht të bazuar ankesën e OE ankues. Ndërsa nëse AK ka ende interes për zhvillim të këtij aktiviteti të prokurimit, lëndën ta kthej ne ritender.

Në fjalën përfundimtar eksperti shqyrtues deklaroj; qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 13.02.2017

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke pasur parasysh raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se në këtë procedurë nuk është përgatitur dosja e tenderit konform nenit 27 të LPP-së, pasi që në dosje të tenderit nuk është kërkuar certifikata e TVSH-së, ndërsa tek njoftimi për kontratë është kërkuar që operatorët ekonomik duhet të kenë edhe certifikatën e TVSH-së, kurse në nenin 27 paragrafi 4 shkruan qartë që "*Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike*". Prandaj duke pasur parasysh këtë fakt, ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet dhe obligohet autoriteti kontraktues që në të ardhmen të ketë parasysh që kërkesat e dosjes së tenderit duhet të përputhen dhe të jenë të njëjta me kërkesat e njoftimit për kontratë. Paneli shqyrtues konstaton se dosja e tenderit nuk është përgatitur konform nenit 27 të LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

z. Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Ministria e Administratës Publike

1x1 OE "Stewart Inspect Kosova sh.p.k"-Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.